



Shumë kohë më parë urrejtja e pushtetit dhe intoleranca i dëboi komediantët jashtë vendit të tyre.

Sot, aktorët dhe trupat teatrore kanë vështirësi të mëdha për të gjetur hapsira teatrale dhe publik, e gjithë kjo për shkak të krizës.

Qeveritarët pra, nuk kanë më probleme për të kontrolluar ata që shprehen me sarkazëm e ironi, përderisa aktorët nuk kanë as hapsira, por edhe as kujt ti drejtohen.

Kryekëput e kundërta e kësaj gjendjeje ishte në Italinë e Rilindjes – kush kishte në dorë pushtetin i duhej të merrej seriozisht me komediantët, të cilët kishin pas vetes morinë e publikut.

Është i njohur fakti që një eksod i madh i aktorëve të komedisë së artit ndodhi pikërisht në shekullin e Kundrareformës, e cila dekretoi shpërbërjen e çdo hapsire teatrale, sidomos në Romë, ku komediantët u damkosën si blasfemi për qytetin e shenjtë. Papa Inoçenti i XII-të, i vënë nën presionin e pjesës më të errët të borgjezisë dhe morisë së klerikëve urdhëroi në 1697 shkatërrimin e teatrit të Tordinonës, skena e së cilit, sipas moralistëve kishte parë më të madhin numër demonstrimesh të pahijshme.

Po në epokën e Kundrareformës kardinali Carlo Borromeo, që përgjigjej për Veriun i ishte kushtuar një veprimtari të zellshme për tu shpjeguar “bijve të Milanos” që, duhej bërë medoemos një ndarje për të kuptuar që arti, si forca shpirtërore edukuese më e madhe nuk ka asgjë të përbashkët me profanitetin e fodullëkun e teatrit. Në një letër të drejtuar kolegëve të tij ai do të shprehet kështu: “Ne, që jemi të ngarkuar me detyrën e çrrënjësjes të së keqes, jemi të përbetuar që të përçojmë në flakë tekstet e pallavrave të turpshme, për ti zhgulur ata nga kujtesa e njerëzve, e bashkë me letrat të persekutojmë edhe ata që i botuan e i përhapën. Por, padyshim, ndërkohë që ne ramë në gjumë, Demoni punoi me dinakëri të pashembullt. E keqja që shihet me sy penetron në shpirt më shpejt se nëse lexohet! Më penetruese të egër se fjala e thënë e shoqëruar me xhest, që na trullosi mendjet e rinoshëve e vajzukeve tona të brishta nuk mundet të jetë asnjë fjalë që gjithsesi shtrihet e vdekur në faqe të librit. Prandaj është e domosdoshme dhe urgjente të zhgulum aktorët nga qytete tona, ashtu siç bëhet me shpirtat e mallkuar.

Prandaj, të shpresojmë që zgjidhja e vetme e krizës është që kundra nesh, sidomos kundra të rinjve të sotëm që aspirojnë të mësojnë artin e teatrit të ngrihet një persekutim i tillë... nga ku do të lindë një diasporë komediantësh, e cila me çdo kusht nga kjo shtypje do të nxjerri materialin e spektaklit të ri.

Dario Fo

Translation: Ilir Dragovoja